



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 1077/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Sokol Rexhaj kandidate për anëtarë të kuvendit komunalë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Pejë paraqitur kundër Komisionerëve të Vendvotimeve, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor dhe manipulimit të votave në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

#### **VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Sadik Halitjaha kandidate për anëtarë të kuvendit komunalë në Pejë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

#### **Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Sokol Rexhaj kandidate për anëtarë të kuvendit komunalë nga PDK-ja në Pejë në të cilën pretendon se me anë të kësaj ankese kërkoj që të verifikohet edhe njëherë procesi i numërimit të votave të tij pasi që në disa qendra të votimit ka pasur më shumë vota, mendon se tani i mungojnë rreth 70 vota.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

## **Ankesa është e pabazuar**

PZAP-i konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar asnjë provë dhe dëshmi bindëse që është bërë një shkelje e tillë, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullores së PZAP-I lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 1077/2013 më datën 06.12.2013



***Këshillë Juridike:*** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24( njëzetekatër) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.